

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E SHËRBIMIT PYJOR, ELBASAN**

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Elbasan me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe mjedisore” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2014 deri me datë 31.05.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.124, datë 21.09.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 515/7, datë 21.09.2015, dërguar z. Rezart Kovaçi, Drejtor në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Elbasan, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

*1. Mbi zbatimin e detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit:*

Drejtoria e Shërbimit Pyjor Elbasan nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm. Konkretisht nga 13 masa organizative të rekomanduara janë marrë në konsideratë dhe janë zbatuar plotësisht 9 masa, 1 masë është në proces dhe 3 masa nuk janë zbatuar, ndërsa në lidhje me realizimin e masave të zhdëmtimit, masa e vetme e rekomanduar është marrë në konsideratë dhe zbatuar plotësisht. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 10 - 12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në proces zbatimi.

***Menjëherë dhe vazhdimisht***

*2. Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit.*

Nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan, në periudhën e hartimit të projektbuxhetit sipas viteve respektive, për vitet pasardhëse nuk është bërë kërkesë për miratimin e fondeve nga Ministria e Mjedisit për ndjekjen e proceseve gjyqësore apo për investime në infrastrukturë për pyjet shtetërore dhe për zonat e mbrojtura. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 12 - 15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan, të merren masa për hartimin sa më real dhe objektiv të projektbuxhetit, duke bërë reflektimin e detyrimeve afatshkurtra ndaj të tretëve dhe detyrimet e të tretëve ndaj Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan, dhe t’ia dërgoj për miratim Ministrisë së Mjedisit brenda afateve ligjore.

***Vazhdimisht***

*3. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë pagat dhe shpërblimet e punonjësve.*

Urdhrat e ministrit për largim nga puna mbi bazën e propozimeve të bëra nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan, z. .... për vitin 2014, kanë anashkaluar procedurat ligjore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan është paditur nga 34 punonjës për periudhën Janar 2014 deri në Maj 2015. Urdhrat e ministrit për largim nga puna janë në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe

shërbimin Pyjor”, i ndryshuar, e për pasojë gjykatat kanë pranuar paditë e punonjësve. Me vendim të formës së prerë, Gjykata ka kërkuar dëmshpërblimin nga institucioni për 19 punonjës, në vlerën **18,828,470 lekë, me pasojë efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit**. Nga kjo vlerë, deri më 31.05.2015 janë likuiduar gjithsej 7,386,612 lekë, prej të cilave vlera 1,578,014 lekë është likuiduar nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan, ndërsa shuma prej 5,808,598 lekë është likuiduar nga Ministria e Mjedisit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 15 - 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

*Për sa më sipër rekomandojmë:*

### **I. Për Ministrinë e Mjedisit**

Ministria e Mjedisit, të analizojë dhe evidentojë përgjegjësitë konkrete për **efektin financiar negativ në vlerën 18,828,470 lekë**, të shkaktuar nga anashkalimi i procedurave ligjore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

*Menjëherë*

### **II. Për Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Elbasan**

Zyra juridike e institucionit të marrë masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit, dhe për çdo rast, vendimet gjyqësore të formës së prerë të ekzekutohen vullnetarisht për të eliminuar shpenzimet e përbarimit privat.

*Vazhdimisht*

*4. Mbi zbatimin e ligjshmërisë të prokurimeve me fonde publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.*

-Në të gjitha rastet për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë, mungojnë kërkesat për të argumentuar në mënyrë të saktë për përcaktimin e nevojave nga sektorët ose degët përkatëse për mallra, punë apo shërbime, mbi bazën e të cilave del urdhri i prokurimit, veprime në kundërshtim me UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë”.

-Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, rezultuan mangësi në hartimin dhe plotësimin e dokumenteve standarde, si dhe mangësi në realizimin procedurës sipas një radhe kronologjike.

-Në tre raste njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, janë ngritur me të njëjtin urdhër, në kundërshtim me pikën 2/ç të Kreut V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Në dy raste kontratat e nënshkuara më datë 12.12.2014 nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. .... dhe firmës ..... , janë nënshkuar para njoftimit të fituesit, në kundërshtim me Kreun V, pika 1 shkronja ç dhe Kreun III, pika 2 shkronja f të VKM nr. 1 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, datë 10.01.2007, i ndryshuar dhe nenit 58 pika 3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-Procedura e prokurimit të “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” me objekt “Ruajtja me SHRSF të zyrave të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Elbasan dhe ambienteve të Fidanishtes Cërrik për periudhën duke filluar më datë 21.04.2014 deri në lidhjen e kontratës me operatorin fitues që do të dalë nga tenderi për vitin 2014”, është përzgjedhur nga titullari i autoritetit kontraktor, në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, duke shmangur haptazi procedurat konkurruese të prokurimit.

-Titullari i autoritetit kontraktor z. .... ka nënshkuar kontratë shtesë për shërbime “Ruajtje me SHRSF të zyrave të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan dhe ambienteve të fidanishtes

Cërrik”, pa asnjë mbështetje ligjore a teknike që të justifikojë këtë shtesë kontrate, duke shmangur konkurrencën dhe procedurat normale të prokurimit. Veprime në kundërshtim me nenin 1, nenin 29, pika 4 dhe nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Kreu IV, pika 5/a e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje e rrugëve autopsyjore” 2014 nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave është përgatitur raporti përmbledhës i zhvillimit të procedurës së prokurimit duke mos vepruar konform dispozitave ligjore të prokurimit publik për respektimin e afateve kohore në lidhje me ushtrimin e të drejtës së ankimit nga operatorët ekonomikë, në kundërshtim me Kreun V, pika 4/gj të VKM nr. 1 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, datë 10.01.2007, i ndryshuar dhe nenin 63, pika 1.1 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Pyllëzim faqet Guri i Zi dhe Krastë e Madhe”:

- nuk janë argumentuar me hollësi kriteret e kualifikimit, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, në kundërshtim me pikën 2/a të VKM nr. 1 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, datë 10.01.2007, i ndryshuar.
- operatori ekonomik ..... i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e veçanta të pranimit lidhur me numrin dhe llojet e makinerive në pronësi/qira të kërkuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me nenin 53/3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- Njoftimi i fituesit i është komunikuar operatorit ekonomik ..... në kundërshtim me parashikimin e nenit 63, pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar duke mos respektuar afatet kohore ligjore në lidhje me të drejtën e ankimesit për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.
- nga Autoriteti Kontraktor nuk është respektuar afati i kthimit të përgjigjes në lidhje me sqarimet për ndryshimet në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Ruajtje me SHRFS të zyrave të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan dhe ambienteve të fidanishtes Cërrik” për vitin 2014:

- Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar me hollësi kriteret për kualifikim sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës që prokurohet, në kundërshtim me pikën 2, gërma “a” e Kreut V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.
- Titullari i Autoritetit Kontraktor ka vendosur të pranojë kërkesën për ndryshimin në dokumentet e tenderit edhe pse ka kaluar afati ankimor prej 7 ditë, në kundërshtim me nenin 63 pika 1.1 dhe pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- Titullari i Autoritetit Kontraktor ka hartuar një shtojcë për ndryshimin e dokumenteve të tenderit 2 (dy) ditë pas afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave, në kundërshtim me nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- Njoftimi i fituesit është publikuar në faqen zyrtare të internetit të APP në kundërshtim me nenin 58, pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. ...., më datë 26.12.2014, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Ruajtje me SHRFS të zyrave të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan dhe ambienteve të fidanishtes Cërrik”, për vitin 2014, ka nënshkruar kontratë

shtesë me fuqi prapavepruese, me anë të së cilës vlera e kontratës fillestare është rritur me 431,323 lekë, duke ndryshuar pagën minimale mujore të rojeve për periudhën 01.09.2014-31.12.2014. Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 58, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe si i tillë është një veprim juridik i pavlefshëm në kuptimin e nenit 92, gërma “a” të Kodit Civil. Për këtë arsye **vlera e kontratës shtesë prej 431,323 lekë me TVSH, përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

-Më datë 31.12.2014 Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka nënshkruar një kontratë shtesë, pa ndjekur procedurat normale të prokurimit dhe pa asnjë mbështetje ligjore a teknike për justifikimin e kësaj kontrate, duke shmangur konkurrencën. Veprime në kundërshtim me nenin 1, nenin 29, pika 4 dhe nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Kreu IV, pika 5/a e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Në të gjitha rastet e prokurimeve me vlerë të ulët, komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka bërë përlllogaritje të saktë të vlerës së kontratës duke mos testuar tregun për të marrë tregues të çmimeve për punët, mallrat apo shërbimet, si dhe nuk ka mbajtur procesverbal në lidhje me këtë. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2/c.

-Në 4 raste të prokurimeve me vlerë të ulët, nuk ka një urdhër nga Titullari për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave ose të kryerjes së shërbimit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42. (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 18 - 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

#### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Për zbatimin dhe përmbushjen me përpikmëri të planit të prokurimit të miratuar, me qëllim përdorimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efizienz të burimeve financiare:

- Autoriteti Kontraktor, të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.
- Nga Drejtori t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, për arsye se në disa raste konstatohet jo korrekt.
- Të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me leverdinë ekonomike dhe të paraqiten kërkesat e argumentuara për mallra, punë apo shërbime, mbi bazën e të cilave hartohen urdhrat e prokurimit.

#### ***Menjëherë dhe vazhdimisht***

Njësia e prokurimit si dhe komisioni i prokurimit me vlera të vogla, në të gjitha rastet, në dokumentimin e prokurimeve të zbatojnë rrjedhën kronologjike të kryerjes së veprimeve dhe ngjarjeve ekonomike sipas kërkesave ligjore, dhe në pajtueshmëri me përputhjen dhe rregullshmërinë financiare.

#### ***Menjëherë dhe vazhdimisht***

Të merren masa nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit, Elbasan për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim për çdo rast të marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara, dhe për çdo rast

të punimeve të kryera, në zbatim të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ”.

#### ***Menjëherë dhe vazhdimisht***

Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan në zbatim të kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, të marri masa, për të bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit Publik, nëpërmjet APP-së, me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale që mbulojnë këto funksione.

#### ***Menjëherë dhe vazhdimisht***

*5. Mbi zbatimin e procedurave për dhënien me qira të pyjeve, dhe kullotave në administrim të DSHP Elbasan, evidentimi dhe monitorimi i zbatimit të kontratave.*

-Nga auditimi i kontratave të qirasë rezultoi se nga disa subjekte private nuk është arkëtuar vlera e kontratës së qirasë. Nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan nuk janë llogaritur dhe as nuk janë mbajtur kamatë vonesat sipas kushteve të kontratës. Shuma e rezultuar nga mos arkëtimi i këtyre detyrimeve, në kuptimin e neneve 486 dhe 640 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, konsiderohet si **dëm ekonomik me vlerë totale 3,930,806 lekë.**

-Në procesin e dhënies së kullotave e livadheve me qira, për kullotjen e bagëtive dhe kositjen e barit, nga ana e Seksionit të Administrimit dhe Menaxhimit, nuk është hartuar plani i mbarështimit të kullotave, në kundërshtim me nenin 14, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar me ligjin nr. 9996, datë 22.08.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin Kullosor”.

-Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan, nuk ka miratuar në Ministrinë e Mjedisit listën e kullotave të gatshme për kullotje për sezonin përkatës, si dhe sipërfaqet që përjashtohen nga kullotja, në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” dhe pikën 1, kreun II, të Udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari”.

-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Elbasan, nuk ka shpallur brenda muajit shkurt të çdo viti listën e kullotave të gatshme për kullotje e kositje për sezonin përkatës, si dhe sipërfaqet që përjashtohen nga kullotja, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, dhe pikën 2 të Kreut II të Udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari”.

-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Elbasan nuk ka hartuar plan-veprimin për dhënien me qira të fondit kullosor, veprim ky në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, si dhe pikën 1, kreu II, të udhëzimit nr. 4, datë 10.04.2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari”. (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 38 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Grupi i punës sipas seksioneve përkatëse të rretheve të kryejë monitorimin e kontratave në mënyrë kronologjike dhe raportimin e tyre pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan, për arkëtimin në kohë të të ardhurave sipas kërkesave ligjore dhe kushteve të kontratave përkatëse.

***Vazhdimisht***

Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan të bëjë një analizë të hollësishme të debitorëve dhe kreditorëve, për të evidentuar ato subjekte për të cilat duhet të kërkohet vjelja e detyrimit në rrugë gjyqësore, si dhe shkaqet e krijimit të detyrimeve të subjekteve ndaj shoqërisë.

#### ***Menjëherë dhe vazhdimisht***

Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan të marrë masa që në zbatim të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar, për çdo vit kalendarik, para dhënies me qira të sipërfaqes së kullotave, të hartoj planet e mbarështimit të kullotave, si dhe t'ia dërgoj për miratim Drejtorisë përkatëse në Ministrinë e Mjedisit.

#### ***Menjëherë dhe vazhdimisht***

Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan, në zbatim të kërkesave ligjore, të marrë masa që brenda muajit shkurt të çdo viti të shpall listën e kullotave të gatshme për kullotje e kositje për sezonin përkatës dhe të dërgoj për miratim në Ministrinë e Mjedisit, listën e kullotave në inventar dhe ato të gatshme për sezonin përkatës, si dhe sipërfaqet që përjashtohen nga kullotja.

#### ***Menjëherë***

Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan, të hartojë plan-veprimin për dhënien me qira të fondit kullosor, plan i cili duhet të përmbajë parcelat konkrete, sipërfaqen, vendndodhjen, kapacitetin kullosor, infrastrukturën që e shoqëron, pjesën përgatitore për hartimin e procesverbalit të vlerësimit të kullotës, masat mbi zbatimin e mënyrave të mbarështimit të kullotave, në mënyrë të veçantë për parandalimin e zjarreve, gërryerjes dhe të degradimit të tokës, ruajtjen e mbulesës barishtore nga mbikullotja dhe mirëmbajtja e infrastrukturës, në veçanti asaj ujëmbajtëse, masat për ruajtjen e ekosistemeve natyrore kullosore, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve kullosore, ruajtjen dhe nxitjen e aftësive prodhuese të kullotave dhe livadheve në përputhje me kërkesat ligjore.

#### ***Menjëherë***

6. Mbi zbatimin e planeve të mbarështimit të pyjeve, kullotave si dhe zbatimi i planit të menaxhimit në zonat e mbrojtura në administrim dhe pronësi të DSHP, komunave dhe privatëve.

-Zonat e Mbrojtura nuk kanë një plan të mirëfilltë menaxhimi, për pasojë këto zona nuk menaxhohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

-Për Zonën e Mbrojtur "Shebenik-Jabllanicë" dhe "Mali i Tomorit" si "Park Kombëtar" nuk është hartuar plani i mbarështimit. Zonat e Mbrojtura kanë si plane mbarështimi vetëm ato të hartuar në nivel ekonomie pyjore të viteve 1985-2002, tashmë jo-aktual (pasi nuk është ajo gjendje në terren me atë që është e përcaktuar).

-Ish-seksioni i Zonave të Mbrojtura nuk disponon një dokumentacion të plotë në lidhje me subjektet që ushtrojnë aktivitet në këto zona dhe ku gjurmët e projekteve janë në ngastrat pyjore të ekonomisë Pyjore (Zonë e Mbrojtur e kategorisë IV). (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 41 - 46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

#### **I. Për Ministrinë e Mjedisit**

Ministria e Mjedisit të hartojë planet e menaxhimit për Parkun Kombëtar të ekosistemit natyror "Shebenik-Jabllanicë" i shpallur me Vendim nr. 640, datë 21.5.2008 dhe për Parkun Kombëtar me sipërfaqe të zgjeruar të ekosistemit natyror "Mali i Tomorit", i shpallur me vendim nr. 472, datë 18.07.2012, për ruajtjen e cilësisë së zonës dhe nxitjen e zhvillimit ekologjik të mjedisve përreth saj dhe zbatimin e kërkesave për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të zonës në zbatim të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar me ligjin nr. 9868, datë 04.02.2008.

## **II. Për Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Elbasan**

Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan të marrë masa për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave pronë shtetërore, në zbatim të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, i ndryshuar, në mënyrë që administrimi dhe zhvillimi i fondit pyjor kombëtar në administrim të këtij institucioni të bëhet mbi bazën e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe shumë-funksional të pyjeve e kullotave, si dhe të përgatitet skema për monitorimin afatgjatë të kushteve të pyjeve.

*Menjëherë*

Të merren masa që, bashkëpunimi i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan, me institucionet e tjera përkatëse si, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Inspektorati i Lartë i Mjedisit të jetë sa më real, i cili duhet konkretizuar nëpërmjet hartimit të plan-veprimeve midis këtyre institucioneve, si dhe duke bërë listimin e saktë dhe elektronik të të gjitha subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fondin pyjor e kullor me qëllim ushtrimin e kontrolleve në këto subjekte, për dokumentacionin ligjor që ato duhet të kenë, si dhe pajisjen e tyre me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit të tyre, si: karriera ndërtimi (gurore e lavatriçe), antenat e kompanive celulare, lokale, etj, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në funksion të shfrytëzimit të pasurisë me interes publik.

*Brenda datës 31.03.2016*

### *7. Mbi ruajtjen rehabilitimin, administrimin dhe zhvillimin e fondit pyjor kombëtar.*

-Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan nuk ka përgatitur skemën për monitorimin afatgjatë të kushteve të pyjeve ku të përcaktohej vazhdimësia dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre, masat për mbrojtjen nga ndotjet, ruajtjen e ekuilibrave të sistemeve ekologjike etj. Marrja e masave të tilla duhet parashikuar në planet e mbarështimit dhe është e ndërvarur nga realizimi i këtyre planeve, të cilat mungojnë sepse nuk janë hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan për sipërfaqen e pyjeve pronë shtetërore, në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar.

-Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan, ka anashkalluar procedurat ligjore për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqes 3.5 ha që ndodhet në ngastrën 170/a, me numër rendor 59, në ekonominë pyjore “Përrenjas”, si dhe sipërfaqes prej 4.7 ha në nëngastrën pyjore 66/d, me numër rendor 155, dhe 1.8 ha në nëngastrën pyjore 68/b me numër rendor 162, të cilat bëjnë pjesë në ekonominë pyjore “Vidhan Skënderbegas”. Këto sipërfaqe janë hequr nga fondi pyjor dhe i kanë kaluar këtij subjekti pa Vendimin e Këshillit të Ministrave, por duke u bazuar vetëm në Raportin Teknik të hartuar nga Seksioni i Shërbimit të Pyjeve dhe Shërbimit Këshillimor të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan, në kundërshtim me nenin 17, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar.

-Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan nuk ka të organizuar një sistem të konsoliduar për parandalimin dhe marrjen e masave për shuarjen e zjarreve. Në fondin pyjor kombëtar si dhe në Zonat e Mbrojtura mungon infrastruktura dhe inventari i nevojshëm, për të bërë të mundur parandalimin dhe neutralizimin që në shfaqjen e parë të vatrave të zjarrit. Mungon personeli i nevojshëm për vrojtim-sinjalizimin si dhe nuk janë planifikuar dhe çelur fonde operative nga ana e Ministrisë së Mjedisit me qëllim marrjen e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve.

-Në buxhetin e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Elbasan, nuk janë planifikuar fonde për shtimin e sipërfaqes pyjore, për punime mbrojtëse dhe ripërtëritëse, me qëllim rehabilitimin, zhvillimin e pyjeve, parandalimin dhe kufizimin e veprimtarive shkatërruese në pyje.

-Njësitë e Qeverisjes Vendore nuk kanë planifikuar dhe çelur fonde nga të ardhurat e realizuara për ruajtjen, mirëmbajtjen, si dhe kryerjen e punimeve silvikulturore. Në pyllëzimet e kryera në pyjet komunale, zëniet janë shumë të ulëta dhe shkak kryesor ka qenë moskryerja e shërbimeve, si dhe dëmtimi nga kullotja. Pra megjithëse komunat ku janë kryer këto punime kanë pasur fonde (të krijuara nga pyjet) në dispozicion, ato nuk kanë realizuar shërbimet për mbrojtjen e nevojshme.

-Në kadastrën e fondit pyjor dhe kullosor, janë të pasqyruara sipërfaqja me bimësi pyjore dhe inproduktive prej 30,931.1 ha, nga e cila 16,853.39 ha, në pronësi të shtetit, 13,942.84 ha në pronësi të komunave dhe 139.94 ha pronë private, të cilat duhet të rehabilitohen nëpërmjet agropylltarisë. Ky fenomen është më i theksuar në sipërfaqen me bimësi pyjore dhe atë të zhveshur, si dhe në terrenet pyjore me pjerrësi të madhe. (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 47 - 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan të marrë masa për fillimin e procedurave të nevojshme ligjore, me qëllim ndërprerjen e shfrytëzimit nga subjekti ..... të sipërfaqes prej 10 ha të fondit pyjor dhe kullosor, si dhe rikthimin e saj në gjendjen e mëparshme.

***Menjëherë***

Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan të marrë të gjitha masat tekniko-organizative që në zbatim të VKM nr. 1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve”, të bëjë parandalimin dhe zbulimin në kohë të vatrave të zjarrit dhe shuarjen e tyre. Nga Ministria e Mjedisit të vihen në dispozicion të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan fonde për përmirësimin dhe funksionimin e infrastrukturës, si dhe për ngritjen e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve.

***Vazhdimisht***

Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan të marrë masa që të planifikojë përpara hartimit të projektbuxhetit, si dhe t’i dërgoj për miratim Ministrisë së Mjedisit fonde për investime në sipërfaqet e Fondit Pyjor Shtetëror që kanë nevojë për investim, fonde të cilat, në zbatim të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, duhet të miratohen nga Ministria e Mjedisit, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve, të gjendjes mjedisore dhe të biodiversitetit pyjor, si dhe për përmbushjen e funksioneve ekonomike, ekologjike dhe publike të pyjeve.

***Menjëherë dhe vazhdimisht***

Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan të marrë masa për hartimin e programeve të bashkëpunimit me njësitë e pushtetit vendor me qëllim bashkërendimin e punës për ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve, pavarësisht nga forma e pronësisë.

***Menjëherë***

***8. Mbi zbatimin e procedurave për shfrytëzimin e lendes drusore dhe prodhimeve të dyta pyjore, jo pyjore, fondin pyjor të DSHP, komunave dhe privatëve***

-Nuk ka të dhëna për sipërfaqet e prekura nga zjarri, për lëndën drusore të djegur si dhe për dëmin e shkaktuar në fondin pyjor. Ky sektor duhet të ketë një databazë të vetën në këtë drejtim. Për sa më sipër është në kundërshtim me pikën 2/b, ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”.

-Nga ana e komisionit të vlerësimit të materialit drusor, seksioni pyjor Gramsh, në një rast, nga kontrolli i ushtruar në qendrën e përpunimit të materialit drusor, nuk ndodhej sasia e sekuestruar prej 158 m<sup>2</sup>, por ndodhej vetëm një sasi prej 35 m<sup>2</sup>. Për këtë rast i është kërkuar Inspektoratit



Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe ujërave Elbasan të ndiqen procedurat ligjore në lidhje me konstatimin e mangësive të lëndës drusore të sekuestruar, të rezultuara nga kontrolli. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 52 - 59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Seksioni i Administrim-Menaxhimit dhe seksioni i Policisë Pyjore tashmë si pjesë e Inspektoratit të Mjedisit të marrin masa për të krijuar një databazë elektronike të përbashkët në lidhje me sipërfaqet e prekura çdo vit nga zjarri, të lëndës drusore të djegur, si dhe të dëmit të shkaktuar në fondin pyjor nga katastrofat natyrore ose kundravajtësit ligjor, dhe e cila e duhet të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme në varësi të fazës në të cilën ndodhet çdo kundravajtje administrative apo kallëzim penal, me qëllim bashkërendimin e punës.

***Brenda datës 31.03.2016***

Nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan të ushtrohen kontrole të vazhdueshme dhe tematikë në bashkëpunim me organet e tjera kompetente në qendrat e përpunimit, të shitjes së materialeve drusore, të prodhimeve të dyta pyjore, si dhe bimëve eterovajore.

***Menjëherë dhe vazhdimisht***

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

1. Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. ...., më datë 26.12.2014, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Ruajtje me SHRFS të zyrave të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan dhe ambienteve të fidanishtes Cërrik”, për vitin 2014, ka nënshkruar kontratë shtesë me fuqi prapavepruese, me anë të së cilës vlera e kontratës fillestare është rritur me 431,323 lekë, duke ndryshuar pagën minimale mujore të rojeve për periudhën 01.09.2014-31.12.2014. Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 58, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe si i tillë është një veprim juridik i pavlefshëm në kuptimin e nenit 92, gërma “a” të Kodit Civil. Për këtë arsye **vlera e kontratës shtesë prej 431,323 lekë me TVSH, përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.** *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 18 - 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **431,323 lekë**, përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik ..... si pasojë e kontratës me fuqi prapavepruese të lidhur me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Elbasan.

***Menjëherë***

2. Nga auditimi i kontratave të qirasë rezultoi se nga disa subjekte private nuk është arkëtuar vlera e kontratës së qirasë. Nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan nuk janë llogaritur dhe as nuk janë mbajtur kamatë vonesat sipas kushteve të kontratës. Shuma e rezultuar nga mos arkëtimi i këtyre detyrimeve, në kuptimin e neneve 486 dhe 640 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, konsiderohet si **dëm ekonomik me vlerë totale 3,930,806 lekë.** *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 38 - 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **3,930,806 lekë** të shkaktuar buxhetit të shtetit, për arsye se nga 11 subjekte private nuk janë arkëtuar qiratë vjetore për sipërfaqet e

shfrytëzuara, si dhe nuk janë mbajtur kamatë vonesat sipas kushteve të kontratës, të paraqitur në mënyrë analitike si më poshtë (në mënyrë të detajuar pasqyruar në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Raporti Auditimi):

1. Vlera prej 2,222,406 lekë, subjektit .....
2. Vlera prej 528,000 lekë, subjektit .....
3. Vlera prej 352,000 lekë, subjektit .....
4. Vlera prej 198,350 lekë, subjektit .....
5. Vlera prej 165,000 lekë, subjektit .....
6. Vlera prej 132,300 lekë, subjektit .....
7. Vlera prej 121,000 lekë, subjektit .....
8. Vlera prej 90,200 lekë, subjektit .....
9. Vlera prej 60,500 lekë, subjektit .....
10. Vlera prej 41,250 lekë, subjektit .....
11. Vlera prej 19,800 lekë, subjektit .....

*Brenda datës 31.12.2015*

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, dhe kontratave individuale të punës, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, që në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, të ndërmarri masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore, për:

#### **"Vërejte", për:**

**1.** ....., me detyrë specialist jurist, për arsyet e mëposhtme:

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Ruajtje me SHRFS të zyrave të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan dhe ambienteve të fidanishtes Cërrik”, për vitin 2014, ka hartuar kontratë shtesë me fuqi prapavepruese, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 58 “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 4.

-Nuk ka ndërmarrë nismat e duhura ligjore në lidhje me shlyerjen e detyrimeve në vlerën 3,930,806 lekë nga subjektet private, të krijuara nga mos arkëtimi i qirasë për periudhën objekt auditimi.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Pyllëzim faqet Guri i Zi dhe Krastë e Madhe” njoftimi i fituesit i është komunikuar operatorit ekonomik ..... përpara përfundimit të afatit për të bërë ankesë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 63, pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Ruajtje me SHRFS të zyrave të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan dhe ambienteve të fidanishtes Cërrik” kanë publikuar njoftimin e fituesit në faqen zyrtare të internetit të APP 8 ditë pas marrjes së vendimit në kundërshtim me nenin 58, pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-Si anëtar i komisionit të prokurimit me vlera të vogla, nuk ka bërë përlllogaritje të saktë të vlerës së kontratës duke mos testuar tregun për të marrë tregues të çmimeve për punët, mallrat apo shërbimet, si dhe nuk ka mbajtur procesverbal në lidhje me këtë. Ky veprim bie në kundërshtim

me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2/c.

**2. ....**, me detyrë specialist i financës, për arsyet e mëposhtme:

-Për arsye se nga mos monitorimi dhe mos arkëtimi i kontratave të qirasë për periudhën objekt auditimi rezultoi se i është shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në 3,930,806 lekë. Veprim në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe nenet 486 dhe 640 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Pyllëzim faqet Guri i Zi dhe Krastë e Madhe” njoftimi i fituesit i është komunikuar operatorit ekonomik ..... përpara përfundimit të afatit për të bërë ankesë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 63, pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Ruajtje me SHRFS të zyrave të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan dhe ambienteve të fidanishtes Cërrik” kanë publikuar njoftimin e fituesit në faqen zyrtare të internetit të APP 8 ditë pas marrjes së vendimit në kundërshtim me nenin 58, pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-Si anëtar i komisionit të prokurimit me vlera të vogla, nuk ka bërë përllogaritje të saktë të vlerës së kontratës duke mos testuar tregun për të marrë tregues të çmimeve për punët, mallrat apo shërbimet, si dhe nuk ka mbajtur procesverbal në lidhje me këtë, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2/c.

**3. ....**, me detyrë specialist i kadastrës për arsyet e mëposhtme:

-Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqes totale prej 10 ha pa miratimin me Vendim të Këshillit të Ministrave, por duke u bazuar vetëm në Raportin Teknik të hartuar nga Seksioni i Shërbimit të Pyjeve dhe Shërbimit Këshillimor të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan, në kundërshtim me nenin 17, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Pyllëzim faqet Guri i Zi dhe Krastë e Madhe” njoftimi i fituesit i është komunikuar operatorit ekonomik .....përpara përfundimit të afatit për të bërë ankesë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 63, pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Ruajtje me SHRFS të zyrave të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan dhe ambienteve të fidanishtes Cërrik” kanë publikuar njoftimin e fituesit në faqen zyrtare të internetit të APP 8 ditë pas marrjes së vendimit në kundërshtim me nenin 58, pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

**4. ....**, me detyrë specialist

**5. ....**, me detyrë specialist

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Pyllëzim faqet Guri i Zi dhe Krastë e Madhe” kanë kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik ..... i shpallur fitues i cili nuk plotësonte kriteret e veçanta të pranimit lidhur me numrin dhe llojet e makinerive në pronësi/qira të kërkuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me nenin 53/3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje e rrugëve autopsyjore” 2014 nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është përgatitur Raporti Përmbledhës i Zhvillimit të procedurës së prokurimit duke mos vepruar konform dispozitave ligjore të prokurimit publik për respektimin e afateve kohore në lidhje me ushtrimin e të drejtës së ankimimit nga operatorët ekonomikë. Ky

veprim bie në kundërshtim me Kreun V, pika 4/gj të VKM nr. 1 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, datë 10.01.2007, i ndryshuar dhe nenin 63, pika 1.1 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, drejtuese, menaxhuese dhe ligjzbatuese, të cilat mund të vlerësoheshin me masën disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga detyra” në vartësi të përgjegjësisë së konstatuar për:

1. z. ...., me detyrë drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Elbasan, për periudhën 01.01.2014-31.05.2015; dhe
2. z. ...., me detyrë shef seksioni për periudhën 21.02.2014-31.05.2015.

Meqenëse të dy këta punonjës, aktualisht nuk janë në marrëdhënie pune, masën e propozuar e konsiderojmë të ezauruar.

**D.** Auditimi i zhvilluar në subjektin Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Elbasan, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe vlerësimit mjedisor”, vlerësohet si shumë i dobët. Për këtë arsye, periudha e auditimit do të jetë objekt i një riauditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në një kohë të përshtatshme.

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Orgest Levanai, Genta Brahja dhe Nefail Xhepexhiu , më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Iliazi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.